

Strategjitë Biznesore për Konkurrencë Globale EKM0019

Bartësi i lëndës:	Diellza Gashi Tresi
Email:	diellza.gashi@riinvest.net
Telefoni:	038 224 322
Bartësi i lëndës:	Diana Lekaj
Email:	diana.lekaj@riinvest.net
Telefoni:	

Hyrje

Lënda Strategjitë biznesore për konkurrencë globale eksploron ndërtimin e strategjisë së bizneseve për të arritur pozicionin konkurrues në mjedis vendor dhe global, dhe për të krijuar kapacitete (burime, dije e shkathtësi) që mundësojnë krijimin e përparësive krahasuese në raport me konkurrencën globale. Pas shqyrtimit të gjithanshëm të analizës së mjedisit dhe pozicionit aktual konkurrues, prezantohen opsionet strategjike duke u bazuar në konkurrimin nëpërmjet çmimeve, diferencimit, diversifikimit dhe alternativave tjera strategjike. Vëmendje e veçantë i kushtohet procesit të zhvillimit të strategjisë si dhe organizimit të aktiviteteve menaxheriale për ndërtimin e strategjisë.

Qëllimet

Qëllimi i kësaj lënde është krijimi i aftësive (dijeve dhe shkathtësive) për të vlerësuar pozicionin konkurrues të organizatës si dhe për të zhvilluar strategjitë efektive për arritjen e objektivave të korporatave dhe organizatave të tjera.

Rezultatet e pritura të lëndës

- Studentët do të jenë në gjendje të vlerësojnë pozicionin konkurrues të organizatave, të zgjedhin strategjinë adekuate si dhe të organizojnë aktivitete për ndërtimin e strategjisë.
- Studenët janë në gjendje të bëjnë vlerësime kritike të literaturës si dhe problemeve reale biznesore, dhe të propozojnë zgjidhjen e atyre problemeve.
- Studentët demonstrojnë aftësi për punë dhe prezentim ekipore

Programi

Java	Tema	Aktivitetet
1	Hyrje në Strategji dhe Pozicioni strategjik: Mjedisi makro, PESTEL	Diskutim i syllabusit, ligjeratë dhe diskutim i nje rasti studimor
2	Sektorët, forcat konkurruese (5- Forcat e Proterit), grupet strategjike dhe konsumatorët strategjik, shansat dhe kërcënimet	Ligjerata, rast studimi dhe prezantim grupor nga studentet
3	Kapaciteti dhe aftësitë strategjike (bazat e kapacitetit strategjik, krijimi i përparësive konkurruese (VRIN)	Ligjerata, rast studimi dhe prezantim grupor nga studentet
4	Zinxhiri vleror, rrjeti vleror dhe dija organizative - SWOT, Diagnostifikimi i Kapacitetit Strategjik.	Ligjerata, rast studimi dhe prezantim grupor nga studentet
5	Strategjitë konkurruese: Niveli biznesor i strategjisë	Ligjerata, rast studimi dhe prezantim grupor nga studentet
		Ligjerata, rast studimi dhe

6	Strategjia në nivel korporate: portofolio dhe diversifikimi	Ligjerata, rast studimi dhe prezantim grupor nga studentet
7	Matricat e portfolios, metodat e rritjes dhe mjedisi global	Ligjerata, rast studimi dhe prezantim grupor nga studentet

Vlerësimi:

Nr.	Lloji	Përqindja	Oblig.	Përshkrimi
1	Prezentim	40		Prezantimi grupor/Poster grupet analizojnë një kompani në aspektin e pozitës së tij në mjedis dhe zgjidhjet e strategjike të organizatës përkatëse
2	Provimi Final	60		Detyrë individuale:përfshin një punim sipas kërkesave dhe pyetjeve të parashtruara lidhur me pozitën e organizatës, zgjidhjet strategjike dhe evaluim të strategjisë.

Kushtet e përsëritjes:

- Sipas rregullores së studentëve të Kolegjit Riinvest, studenti ka të drejtë deri në tri herë të tentojë të kalojë lëndën. Nëse studenti nuk arrin që t'a kalojë lëndën në mundësinë e parë në fund të ligjëratave, atëherë vlerësimet e mëhershme (vijueshmëria, vlerësimet e kollokviumeve) gjatë ligjëratave i ruhen studentit deri në afatin e fundit që e ka për ta dhënë këtë lëndë. - Nëse studenti nuk arrin që ta kalojë lëndën deri në mundësinë e tretë që është në afatin e Shtatorit, atëherë studenti duhet ta përsëris komplet lëndën edhe një herë.

Burimet:

- • Garry Johnson & Kevan Scholes & Richard Whittington: Exploring Corporate Strategy (Text and cases), FT, Prentice Hall, 2011 (Ninth Edition) • Strategic Management from Concept to Implementation, L.J.Bourgeois (Dyrden, Press) * D. Pantaleo (2008) - From Strategy to Execution, Springer • Robbins & Coulter: Management (CH, 7,8,) Prentice Hall 2007 • Artikuj elektronik, sipas kapitujve.

Ndërtimi i ECTS-ve

Aktiviteti	Nr i oreve per Aktivitetin	
Ligjerata:	24	(i)
Ushtrime:	14	(i)
L+U:	38	(i)
Seminar/praktike.:	0	(i)
Studim i vazhdushem:	70	(i)
Pregaditja e Provimit:	30	(i)
Pjesemarrja ne teste:	0	(i)
Pjesemarrja ne provimin final:	2	(i)
Me profesorin dhe asistentin:	14	(i)
Total Ore:	154	(i)
ECTS:	8	(i)